



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

STATISTIČKI BUREAU KOSOVO  
STATISTICAL BUREAU OF KOSOVO  
AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS  
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA  
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Prishtinë, 18.01.2022

Prishtinë, Pristina

04-052-15  
113  
18.01.2022



Agjencia e Statistikave të Kosovës  
Agencija za Statistike Kosova  
Kosovo Agency of Statistics

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NË MES TË

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

AGJENCISË SË STATISTIKAVE TË KOSOVËS

Duke u bazuar se Kuvendi i Republikës së Kosovës, si institucion ligjvënës, miraton Kushtetutën, ligjet, rezolutat, deklarata, si dhe aktet tjera të përgjithshme;

Duke vlerësuar se nevojat e Kuvendi të Republikës së Kosovës, për të hartuar politika, miratuar ligje dhe për të siguruar mbikëqyrjen e duhur të ekzekutivit, duhet të mbështeten në të dhëna të bazuara në dëshmi dhe në mjete hulumtuese (kërkimore);

Duke u bazuar se Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është bartësi kryesor i statistikave zyrtare në Kosovë që merret me mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare statistikore;

ASK, bazuar në zbatimin e dispozitave të ligjit mbi statistikën zyrtare dhe në kodin e praktikave të Statistikave Evropiane (CoP) publikimin dhe shpërndarjen e të dhënave zyrtare e bën në mënyrë objektive të paanshme dhe të njëkohshme për të gjithë shfrytëzuesit. Megjithatë, duke vlerësuar se ofrimi i statistikave zyrtare dhe në kohë për Kuvendin, i ndihmon deputetët të hartojnë politika të bazuara në dëshmi, të miratojnë ligje dhe rezoluta, të hartojnë raporte hulumtuese, dhe të përdorin të dhëna të sakta kur flasin në seancat e Kuvendit, apo kur iu drejtohen publikut të gjerë dhe mediave;

Palët pajtohen të nënshkruajnë këtë memorandum bashkëpunimi.

## **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i këtij memorandumi është bashkëpunimi institucional në mes Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme - Kuvendi) dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës (në tekstin e mëtejme - ASK), për krijimin e një komunikimi të drejtpërdrejtë, efikas, të përdorshëm, të qëndrueshëm, shkëmbim informacioni për ofrimin e të dhënave të bazuara në dëshmi dhe në kohë reale.

## **Neni 2 Objektivat**

1. Shkëmbimi dhe krijimi i të dhënave të bazuara në dëshmi, ku hulumtimi bëhet pjesë integrale e punës së Kuvendit dhe ASK-së.
2. Fuqizimi i kapacitetit aktual të deputetëve për angazhim në arritjen e OZHQ-ve (synimeve për zhvillim të qëndrueshëm).
3. Përdorimi, i të dhënave, nga ana e trupave punuese të Kuvendit, të bazuara në dëshmi, gjatë procesit të politikë bërjes dhe miratimit të ligjeve, si dhe mbikëqyrjes dhe kontrollit parlamentar.

## **Neni 3 Fushat e bashkëpunimit**

1. Krijimi i një qendre statistikore “ Statistics Hub” (aplikacion i bazuar në ueb) në kuadër të Kuvendit të Kosovës, që të forcojë shkëmbimin e informacionit me ASK-në.
2. ASK-ja i ofron Kuvendit të Kosovës, buletine të rregullta dhe periodike, me statistika të përzgjedhura për çështje të përgjithshme, socio ekonomike dhe tregues makroekonomik, në dobi të deputetëve.
3. Hartimi i raporteve kërkimore, analizave politike dhe analizave krahasuese, të bazuara në të dhëna në kohë reale, dhe në tema të përzgjedhura.
4. Përgatitja e deputetëve dhe zyrtarëve të tjerë përkatës, brenda Kuvendit, për t'i shfrytëzuar të dhënat në dobi të punës së tyre në politikë bërje, fjalime, mbikëqyrje parlamentare, etj.
5. ASK-ja furnizon me të dhëna aplikacionin e bazuar në ueb për deputetët dhe Kuvendin, të cilin ata mund ta përdorin për të vlerësuar dhe përmirësuar kapacitetin e tyre aktual, për angazhim në arritjen e OZHQ-ve.
6. Shkëmbimi i shembujve (vizitave shkëmbyese me parlamente të tjera) se si parlamentet dhe parlamentarët mund t'i përmbushin rolet e tyre në zbatimin e OZHQ-ve.
7. Nëpërmjet kësaj marrëveshje, Kuvendit të Kosovës, i sigurohet informacion i nevojshëm dhe i përditësuar rregullisht, për temat e kërkuara, të cilët do të kenë mundësi që t'i përdorin më mirë të

dhënat statistikore, dhe ta argumentojnë linjën e tyre të arsyetimit të politikë bërjes me të dhëna/argumente të evidentuara.

8. Projekti gjithashtu do ta ndihmojë Kuvendin e Kosovës në sigurimin e një llogaridhënie të shtuar dhe mbikëqyrje parlamentare ndaj ekzekutivit.

9. Në planin afatgjatë, do të shërbejë si një hap për lëvizjen drejt bërjes së politikave të bazuara në dëshmi dhe praktikave të vlerësimit të ndikimit të politikave, duke kontribuar kështu në zbatimin e SDG-ve.

10. Kuvendi, konkretisht Drejtorja për Hulumtime, i dërgon ASK-së të dhëna për punën e tyre (p.sh. numrin e ligjeve të miratuara, politikat e hartuara etj.) për t'ia mundësuar Agjencisë të prodhojë të dhëna statistikore zyrtare të dobishme dhe të besueshme, për përdorim të deputetëve.

10. Kuvendi do të angazhohet në përkrahje të ASK-se në aspektin e sigurimit të rritjes së përdorimit të burimeve administrative për qëllime statistikore nga institucionet e ndryshme të Republikës së Kosovës .

#### **Neni 4**

#### **Vlerësimi i bashkëpunimit**

Palët pajtohen të takohen në baza të rregullta, çdo tre muaj, për të vlerësuar përmbushjen e Memorandumit të Bashkëpunimit.

#### **Neni 5**

#### **Detyrimet e palëve**

Palët pajtohen që shpenzimet financiare për zbatimin e këtij memorandumi të mbulohen nga buxheti përkatës i palëve nënshkruese.

#### **Neni 6**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky Memorandum Bashkëpunimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit..

**Palët nënshkruese:**

**Ismet Krasniqi**

**Sekretar i Përgjithshëm  
Kuvendi i Republikës së Kosovës**

**Ilir Berisha,**

**Zëvendësues i Kryeshefit Ekzekutiv të ASK-së**

**Prishtinë, më 18 janar 2022.**